

**GJON BORIÇI**

**KREDITË DHE NDIHMAT KINEZE PËR SHQIPËRINË  
(1956-1975)**

**Nota kineze e 7 korrikut 1978 për ndërprerjen e ndihmave  
dhe kredive Shqipërisë**

Më 7 korrik 1978, Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë Enver Hoxha, kryeministri Mehmet Shehu dhe Nesti Nase ministër i Jashtëm i RPSSH-së, marrin një telegram urgjent nga Pekini prej ambasadorit Behar Shtylla ku njoftoheshin në lidhje me vendimin e qeverisë kineze për ndërprerjen e çdo ndihme dhe kredie ndaj Shqipërisë.<sup>1</sup> Në notën dërguar ambasadës shqiptare, Kina pretendonte se i kishte akorduar ndihma dhe kredi Shqipërisë shumë se 10 miliard yuan<sup>2</sup>. Nga kjo ndihmë kolosale, në Shqipëri, ishin ndërtuar plotësisht 91 objekte, 23 të tjera ishin në përfundim e sipër dhe 17 në projektim apo në shqyrtim.<sup>3</sup>

Në notën kineze, thuhej se, që nga viti 1954, Kina kishte dërguar ndihma të panumërta dhe kredi të mëdha në Shqipëri me kërkesën e qeverisë shqiptare.<sup>4</sup> Më shumë se dy mijë kadro shqiptarë nga të gjitha fushat ishin arsimuar dhe trajnuar në Kinë dhe se ajo e kishte ndihmuar Shqipërinë në një kohë kur vetë ajo po përballonte shumë vështirësi.<sup>5</sup> Gjithashtu, në notë theksohej fakti se nga Kina drejt Shqipërisë ishin

---

<sup>1</sup> *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (më tej: AMPJ), viti (më tej V.) 1978, dosja (më tej: D.) 283, fl. 2. Pjesë nga telegrami i ambasadorit Behar Shtylla: "Deshifrim tepër sekret nga Pekini, shokut Enver, shokut Mehmet, shokut Nesti Nase 7 korrik 1978. Y Xhan më dorëzoi notën 8 faqe. Njofton se 'qeveria kineze pret ndihmën e saj ekonomike dhe ushtarake' dhe pagesat për vitin 1975 për Shqipërinë dhe do të kthejë specialistët, ushtarakët dhe specialistët ekonomikë që punojnë në Shqipëri dhe për të gjitha këto përgjegjësinë ia hedh palës shqiptare. Shpreh shpresën se qeveria shqiptare do të lehtësojë kthimin e tyre. Nota është plot shpifje, shtrembërime e akuza pa bazë. Ia hodha poshtë të gjitha".*

<sup>2</sup> *Po aty*, fl. 5.

<sup>3</sup> *Po aty*.

<sup>4</sup> *Po aty*, fl. 4

<sup>5</sup> *Po aty*, fl. 7-8.

lëvruar mbi 1.8 milion ton grurë, më shumë se 1 milion produkte çeliku kur ajo vetë nuk dispononte mjaftueshëm.<sup>6</sup> Në notë theksohet fakti se, Kina kishte pajisur ushtrinë shqiptare me armë dhe interceptorë të fjalës së fundit.<sup>7</sup> Po ashtu, akuzohej Shqipëria se po përpiqej që defektet e saj në industri t'ia faturonte Kinës.<sup>8</sup> Në fund të notës theksohej me të madhe se ndërprerja e bashkëpunimit ekonomik dhe ushtarak ndërmjet Kinës dhe Shqipërisë ishte shkaktuar plotësisht nga pala shqiptare, e cila duhej të mbante përgjegjësi të plotë.<sup>9</sup> Udhëheqja komuniste shqiptare iu përgjigj notës kineze të 7 korrikut me një letër të gjatë e të ashpër më 29 korrik 1978 ku i hidhte poshtë të gjitha ato se çfarë thuheshin në notën kineze.<sup>10</sup> Nota shqiptare e firmosur nga Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu e konsideronte vendimin e Kinës të pabesë e armiqësor ndaj Shqipërisë.<sup>11</sup> Ajo hidhte poshtë "tetë faktet" e paraqitura nga nota kineze dhe theksonte se Shqipëria do të vijonte të mbronte parimet marksiste-leniniste dhe socializmin ndërkombëtar.<sup>12</sup>

Shqipëria nuk pranonte se kishte marrë mbi 10 miliard yuan kredi nga Kina dhe 1.8 milion ton grurë, por vetëm 3 miliard dhe 436.000 ton grurë dhe çdo gjë tjetër ishte paguar në rrugë tregtare apo me klering.<sup>13</sup> Sipas Hoxhës dhe Shehut, Shqipëria i kishte lëvruar Kinës mbi 1.7 milion ton naftë, mbi 1.3 milion ton bitum, rreth 2.7 milion ton mineral kromi e koncentrat kromi etj.<sup>14</sup>

Gjithashtu, në notën shqiptare, i vihej në dukje Kinës se Partia e Punës e Shqipërisë e kishte mbrojtur Partinë Komuniste të Kinës nga sulmi i revizionistëve hrushovianë në mbledhjen e Bukureshtit dhe në atë të Moskës të Partive Komuniste e Punëtore të vitit 1960.<sup>15</sup> Shqipëria këtë e kishte bërë me vetëdije për të mbrojtur parimet e marksizëm-leninizmit dhe jo për të marrë nga Kina disa fabrika dhe disa traktorë.<sup>16</sup> Kur

<sup>6</sup> *Po aty*, fl. 9.

<sup>7</sup> *Po aty*, fl. 11.

<sup>8</sup> *Po aty*, fl. 40.

<sup>9</sup> *Po aty*, fl. 44.

<sup>10</sup> *Po aty*, V. 1978, D. 284, fl. 73. Letër e Komitetit Qendror të PPSH drejtuar KQ të PKK, 29 korrik 1978.

<sup>11</sup> *Po aty*.

<sup>12</sup> *Po aty*, fl. 75.

<sup>13</sup> *Po aty*, fl. 83.

<sup>14</sup> *Po aty*.

<sup>15</sup> *Po aty*, fl. 75.

<sup>16</sup> *Po aty*.

Shqipëria socialiste, për vite e vite me radhë, mbronte të drejtat e Kinës Popullore në Organizatën e Kombeve të Bashkuara kundër komplotit amerikan sipas Hoxhës, ajo këtë nuk e bënte për interesa materiale, por për të mbrojtur një çështje të drejtë dhe parimore.<sup>17</sup> Kur, Partia e Punës e Shqipërisë dhe klasa punëtore e saj mbështetën qëllimet strategjike të Revolucionit Kulturor të Kinës, këtë sipas Hoxhës nuk e kishte bërë për të marrë ndonjë kompensim, por për të ndihmuar klasën punëtore kineze, komunistët dhe popullin kinez, për ta shpëtuar vendin nga elementët kapitalistë që kishin uzurpuar pushtetin në Kinë.<sup>18</sup> Sigurisht, ky pretendim i Enver Hoxhës bie poshtë pasi Kina ishte “pata që bënte vezë të arta” dhe miqësia me të ishte më shumë sesa e domosdoshme për ruajtjen e pushtetit të tij personal. Për udhëheqjen shqiptare arsyet e vërteta të prerjes së ndihmave e të kredive për Shqipërinë nuk kishin thjesht karakter teknik, por thellësisht politik dhe ideologjik.<sup>19</sup>

Përtej ideologjisë dhe pretendimeve të të dyja palëve lidhur me shifrën reale të ndihmave dhe kredive kineze për Shqipërinë, dhe jashtë çdo lloj paragjykimi, po paraqes këtë artikull studimor për të bërë një përlllogaritje të saktë nga viti 1956 deri në vitin 1978 lidhur me ndihmat dhe kreditë kineze për Shqipërinë. Hulumtimi disavjeçar në arkiva më dha mundësinë që të paraqes shifrat reale jashtë çdo lloj pretendimi nga ana e palëve. Për mendimin tonë, shifrat e dhëna nga të dyja palët, shqiptare dhe kineze nuk janë të sakta.

### **Ndihmat dhe kreditë kineze për Shqipërinë, 1956 - 1960**

Më 22 tetor 1956, Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, Enver Hoxha, thirri një plenum të rëndësishëm për të sqaruar vizitat që kishte bërë si kryetar i delegacionit të lartë në Kinë, Kore të Veriut dhe Mongoli.<sup>20</sup> Interesant është fakti se në këtë mbledhje, përpara se të fillonte të sqaronte vizitën në Kinë, Enver Hoxha bën një ekspozitë të gjatë të marrëdhënieve të Shqipërisë me Jugosllavinë. Udhëheqësi shqiptar i

<sup>17</sup> *Po aty*.

<sup>18</sup> *Po aty*.

<sup>19</sup> *Po aty*, fl. 76.

<sup>20</sup> *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F) 14 / *Arkivi i Partisë-Marrëdhëniet me Partinë Komuniste të Kinës* [më tej: *AP-MPKK*], viti (më tej: V.) 1956, dosja (më tej: D.) 28, fl. 56. Procesverbal i mbledhjes së Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH, 22 tetor 1956.

konsideroi marrëdhëniet me fqinjin verior si të ftohta dhe për këtë, sipas tij, faji ishte i palës jugosllave.<sup>21</sup> Nuk ishte rastësi që lideri komunist shqiptar e filloi mbledhjen duke folur për Jugosllavinë e Titos. Kishte filluar “shkrirja” e akujve në marrëdhëniet sovjeto-jugosllave me vizitat reciproke të Titos dhe Hrushovit në kryeqytetet përkatëse në gjysmën e dytë të viteve '50. Enver Hoxha nuk mund të ndjehej më i sigurtë në marrëdhënien e ngushtë me Bashkimin Sovjetik. Riafrimi sovjeto-jugosllav ishte kërcënimi i radhës për pushtetin e tij. Sipas Hoxhës, Hrushovi gjatë vizitës në Beograd e kishte nxitur Titon që Jugosllavia të përmirësonte marrëdhëniet me Shqipërinë, të ndalte punën agjenturore kundër saj si dhe të hiqte dorë nga tentativat për likuidimin e udhëheqjes politike shqiptare.<sup>22</sup>

Pasi foli tepër gjatë lidhur me marrëdhëniet me Jugosllavinë, Enver Hoxha u ndal tek vizita që zhvilloi në Kinë si kryetar i delegacionit që mori pjesë në Kongresin VIII të Partisë Komuniste Kineze. Interesant është fakti se në takimin me Mao Ce Dunin [Mao Zedong], Enver Hoxhës i duhej t'i përshtatej në maksimumin e mundshëm përshtypjes së Maos për prishjen e marrëdhënieve me Jugosllavinë dhe për figurën e Stalinit. Lidhur me Jugosllavinë, Mao i tha Enver Hoxhës se fajin për këtë e kishte Informbyroja.<sup>23</sup> Ndërsa, në lidhje me Stalinin, kryetari Mao, u shpreh se ai [Stalini] kishte bërë gabime jo vetëm ndaj Jugosllavisë, por edhe ndaj Kinës që në vitin 1927.<sup>24</sup>

Duke patur parasysh edhe fjalimin sekret të Hrushovit në Kongresin XX të Partisë Komuniste të Bashkimit Sovjetik në shkurt 1956, dhe fjalën e Maos kundër “atit” të tij shpirtëror, Enver Hoxhës nuk i mbetej gjë tjetër veçse të përshtatej me situatën. Duke patur parasysh afrimin sovjeto-jugosllav dhe i bindur se aleanca e ngushtë me Moskën nuk do të zgjaste shumë, lideri komunist shqiptar për herë të parë u shpreh se Stalini ishte një udhëheqës me shumë merita, por njëkohësisht kishte bërë

<sup>21</sup> *Po aty*, fl. 57.

<sup>22</sup> *Po aty*, fl. 58. Pjesë nga fjala e Enver Hoxhës në plenum: “Ju i tha haptazi shoku Hrushov Titos doni që udhëheqjen aktuale të partisë dhe të shtetit shqiptar ta likujdoni, kurse ne këtë udhëheqje do ta ndihmojmë dhe do ta mbrojmë, kurse nga ana juaj duhet të ndalohet puna agjenturore që ju zhvillonin në Shqipëri”.

<sup>23</sup> *Po aty*, fl. 32. “Për çështjen e Jugosllavisë nuk keni gabuar as ju, as jugosllavët. Për prishjen e marrëdhënieve me Jugosllavinë tha se gabime të mëdha ka bërë Informbyroja”.

<sup>24</sup> *Po aty*.

edhe gabime të rënda.<sup>25</sup> Enver Hoxha po përshtatej shumë mirë me situatën. Pas prishjes së afërt me Bashkimin Sovjetik, atij i duhej me domosdo një tjetër “strehë” që t’i siguronte vijimësinë e pushtetit. Enver Hoxha nuk heziton ta falënderojë Mao Ce Dunin për ndihmat që Republika Popullore e Kinës kishte filluar të sillte në Shqipëri.<sup>26</sup>

Pas takimit me Maon, Enver Hoxha dhe delegacioni që ai drejtonte patën një takim edhe me kryeministrin e Kinës, Çu En Lai [Zhou Enlai]. Hoxha e cilësoi në fjalën e tij në plenum, kryeministrin e Kinës si njeri jashtëzakonisht të thjeshtë dhe që kishte shprehur dëshirën e plotë për të vijuar ndihmat ndaj Republikës Popullore të Shqipërisë dhe për të zhvilluar një vizitë në Shqipëri.<sup>27</sup> Çu En Lai ishte interesuar se për çfarë mund ta ndihmonte më shumë Kina Shqipërinë dhe Enver Hoxha ishte përgjigjur se për momentin heqja e triskëtimit ishte emergjente në Shqipëri.<sup>28</sup> Interesant është fakti se megjithë ndihmat e mëdha që vinin nga Bashkimi Sovjetik dhe nga vende të tjera të demokracive popullore, përsëri ekonomia e Shqipërisë nuk jepte shenja rikuperimi. Të paturit edhe një “bamiresh” tjetër nuk do të ishte keq për regjimin e Enver Hoxhës.

Më 23 tetor 1956, ambasadori shqiptar në Pekin, Delo Balili, njoftoi Ministrinë e Arsimit të Republikës së Shqipërisë se ishin bërë gati për transport nga Kina ndihma dhe pajisje laboratorike për shkollat dhe nxënësit në Shqipëri.<sup>29</sup> Në mesazhin e tij, ambasadori Balili nuk jepte hollësi për ndonjë faturë financiare që Shqipëria duhej t’i lëvronte Kinës. Më 5 janar 1957, ambasadori Balili i dërgoi Ministrisë së Punëve të Jashtme të RP të Shqipërisë një raport të hollësishëm lidhur me

<sup>25</sup> *Po aty*. Nga takimi i Enver Hoxhës me Mao Ce Dunin: “Pastaj pyeti ç’mendnim ne për Stalinin. Ne i thamë se Stalini është një udhëheqës me shumë merita, po njëkohësisht ai ka bërë edhe gabime të rënda”.

<sup>26</sup> *Po aty*. Fjala e Enver Hoxhës: “Më në fund e falenderova për ndihmën që na ka dhënë Republika Popullore e Kinës. Ai ndërhyri menjëherë dhe tha se nuk ishte nevoja të falenderonim, pikë së pari sepse ndihma që ju kemi dhënë është një gjë fare e vogël pastaj, shtoi ai, ne jemi pjesëtarë të familjes së madhe të kampit të socializmit që ka në krye Bashkimin Sovjetik dhe është njëlloj sikur njëra dorë t’i japë diçka tjetrës, pjesë e të njëjtit trup”.

<sup>27</sup> *Po aty*, fl. 33.

<sup>28</sup> *Po aty*.

<sup>29</sup> *AMPJ*, V. 1956, D.139 B/II-2, fl. 1. Dhurata të qeverisë së RP të Kinës për shkollat tona.

marrëveshjet tregtare dhe lëvrimin e mallrave për vitin 1957.<sup>30</sup> Në këtë raport, ambasadori Balili kërkon që Shqipëria të shlyente të gjitha dërgesat e kërkuara nga ana e Kinës në mënyrë që të mbylleshin të gjitha kontratat e nënshkruara.<sup>31</sup>

Por, Shqipëria ishte ende mjaft e varfër dhe e zhytur në borxhe ndaj Bashkimit Sovjetik. Për të paguar ndihmat dhe kreditë që do të vinin nga Kina, vendi komunist ballkanik duhej të kërkonte një shumë financiare nga Pekini për të patur mundësinë e lëvrimin të mallrave. I detyruar, një vit më vonë, më 7 tetor 1958, Enver Hoxha i drejtohet me një letër të gjatë kryetarit të Kinës, Mao Ce Dun, ku i kërkonte një kredi prej 55 milion rublash\* (150 milion yuan), për pesëvjeçarin e tretë 1961-1965.<sup>32</sup> Nga ana e tij, Mao Ce Duni pranon kërkesën e Enver Hoxhës për akordimin e një kredie prej 55 milion rublash qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë.<sup>33</sup> Kredia prej 55 milion rublash do të kishte një interes prej 15% në vit dhe do të fillonte të shlyhej nga viti 1980 deri më 1990.<sup>34</sup> Me këtë kredi gjatë pesëvjeçarit të tretë 1961-1965 do të ndërtoheshin disa vepra ku ajo që binte në sy ishte ndërtimi i fabrikës së qelqurinave me kapacitet 5600 ton prodhim qelqesh dhe fabrikë për ambalazhe.<sup>35</sup> Deri në vitin 1960, kjo ishte kredia e vetme sipas dokumenteve që kemi hulumtuar që është akorduar nga qeveria e Republikës Popullore të Kinës.

<sup>30</sup> *Po aty*, V. 1957, D. 130 BII-1, fl. 5. Material mbi marrëdhëniet ekonomike midis dy vendeve.

<sup>31</sup> *Po aty*, fl.

\* Në vitet '60 kursi i këmbimit ndërmjet rublës dhe yuan ishte: 1 rubël=2.73 yuan.

<sup>32</sup> *AQSH*, F. 14 / AP-MPKK, V. 1958, D. 1, fl. 7. Letra të shkëmbyera midis Enver Hoxhës dhe Mao Ce Dunit mbi kërkesën e KQ të PPSH dejtuar PKK për t'i akorduar Shqipërisë një kredi prej 55 milion rublash gjatë periudhës së parë të pesëvjeçarit të tretë 1961-1965.

<sup>33</sup> *Po aty*, fl. 10. "Komiteti Qendror i Partisë Komuniste Kineze dhe qeveria e Republikës Popullore të Kinës pranojnë dhënien e një kredie prej 55 milionë rublash qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë ... Përsa i përket çështjeve në lidhje me kredinë dhe furnizimin me materiale kryesore, do të shqyrtohen nga organet përkatëse të qeverive tona. Përshëndetje komuniste, Mao Ce Dun, 12 dhjetor 1958".

<sup>34</sup> *AMPJ*, V. 1959, D. 189 BII-2, fl. 1. Informacion mbi marrëveshjet e përfunduara me RP të Kinës gjatë vitit 1959.

<sup>35</sup> *Po aty*.

### Ndihmat dhe kreditë kineze, 1961-1965

Vitet 1961-1969 ishin vitet më të suksesshme të marrëdhënieve shqiptaro-kineze. Janë pikërisht këto vite, që i bënë këto marrëdhënie të veçanta. Duke shfrytëzuar acarimin kino-sovjetik, Shqipëria e Enver Hoxhës u lidh kokë e këmbë me Republikën Popullore të Kinës dhe mori prej saj shumë ndihma dhe kredi. Nga ana tjetër, duke qenë shtet anëtar i Organizatës së Kombeve të Bashkura (OKB), Shqipëria shfrytëzoi me mjeshtëri mungesën e Kinës në këtë organizëm të rëndësishëm ndërkombëtar për t'u bërë zëri i Pekinit në institucionin më të rëndësishëm të globit.

Nga data 17 deri më 30 janar 1961, një delegacion i lartë qeveritar shqiptar i kryesuar nga Spiro Koleka, zëvendëskryeministër i Republikës Popullore të Shqipërisë, zhvilloi takime intensive me kryeministrin e Republikës Popullore të Kinës, Çu En Lai dhe Li Hsien Nien [Li Xiannian, ministër i Financave 1954-1969], për veprat që do të ndërtoheshin në Shqipëri me kreditë dhe ndihmat e Kinës.<sup>36</sup> Tri ishin çështjet kryesore që u diskutuan në atë takim: Tregtia për vitin 1961; 2. Tregtia dhe bashkëpunimi me afat të gjatë për vitet 1961-1965; 3. Çështje ushtarake.<sup>37</sup>

Kryeministri kinez u shpreh në takim se Shqipëria për pikën e parë do të merrte nga Kina 20 milion rubla dhe priste që Shqipëria t'i kthente 9 milion rubla me një defīcit prej 11 milion rublash.<sup>38</sup> Deficiti i vitit 1960 që Shqipëria duhej t'i jepte Kinës ishte 10 milion rubla.<sup>39</sup> Gjithsej, vetëm për këto dy vite, Shqipëria i detyrohej Kinës 21 milion rubla (57 milion yuan) sipas kryeministrit kinez, fakt që nuk u përgënjeshtroi nga Spiro Koleka.<sup>40</sup>

Lidhur me çështjen e dytë, Shqipëria do të merrte nga Kina 100 milion rubla të cilat do të përdreshin për mekanizimin e bujqësisë dhe kërkonte të ndërtoheshin 125 vepra me ndihmën e specialistëve kinezë.<sup>41</sup> Përsa i përket çështjes së tretë dhe më të ndjeshme për Enver Hoxhën, atë

<sup>36</sup> AQSH, F. 14 / AP-MPKK, V. 1961, D. 1, fl. 1. Takimi i Spiro Kolekës me Çu En Lain, 17 janar 1961.

<sup>37</sup> *Po aty*.

<sup>38</sup> *Po aty*, fl. 2.

<sup>39</sup> *Po aty*.

<sup>40</sup> *Po aty*.

<sup>41</sup> *Po aty*, fl. 3.

të ndihmës ushtarake, Kina nuk mund të kënaqte plotësisht Shqipërinë. Në raportin përfundimtar që hartoi Spiro Koleka, të cilin ia paraqiti Enver Hoxhës, konkludonte se nga 700 milion rubla që pati kërkuar i udhëzuar nga Komiteti Qendror i Partisë së Punës të Shqipërisë, kinezët me marrëveshje kishin akorduar 500 milion rubla (1.365.000.000 yuan), të cilat ndaheshin 100 milion rubla për mallrat ushqimore, 100 milion rubla për bujqësinë dhe pajisjet përkatëse dhe 300 milion rubla për veprat.<sup>42</sup>

Duke qenë se nuk mbeti fort i kënaqur nga kredia kineze për vitin 1961, Enver Hoxha dërgoi në Kinë, Abdyl Këllezin [ministër i Ekonomisë], më 23 dhjetor 1961 për të negociuar mbi një kredi dhe ndihmë të re nga ana e Kinës.<sup>43</sup> Në raportin e ambasadës shqiptare në Pekin dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës Popullore të Shqipërisë jepen detaje nga takimi i Abdyl Këllezit me Çu En Lain dhe kërkesat e ministrit shqiptar për ndihmë dhe kredi të re nga ana e Kinës. Për të përmbushur këtë dëshirë të re të Shqipërisë, Kina do të duhej të blinte nga Italia pajisje që kushtonin 12 milion dollarë.<sup>44</sup> Gjithsej kredia do t'i kushtonte Shqipërisë 40 milion dollarë.<sup>45</sup> Pas diskutimeve të gjata, Çu En Lai pranoi që kredia, e cila do t'i jepej Shqipërisë për vitin 1962 të ishte 25-30 milion rubla (81.900.000 yuan).<sup>46</sup>

Shqipëria në gjysmën e parë të viteve '60 merrte në mënyrë të fshehtë sasi të konsiderueshme valute të huaj nga Kina.<sup>47</sup> Sesa ishte kjo shumë, dokumentet nuk na e sqarojnë. Por, ndihmat dhe kreditë e konsiderueshme që po merrte Shqipëria nga Kina do të konsolidoheshin edhe më shumë pas dy vizitave të njëpasnjëshme në Shqipëri të kryeministrit kinez Çu En Lai në vitet 1964 dhe 1965.<sup>48</sup> Vëllimi i

<sup>42</sup> *Po aty*, fl. 15.

<sup>43</sup> *Po aty*, F. 14 / AP-MPKK, V. 1962, D. 1, fl. 8. Mbi vizitën e Abdyl Këllezit në Kinë më 23 dhjetor 1961, dërguar nga ambasada shqiptare në Pekin, Ministrisë së Punëve të Jashtme në Tiranë, 14 janar 1962.

<sup>44</sup> *Po aty*, fl. 17.

<sup>45</sup> *Po aty*.

<sup>46</sup> *Po aty*. Mbi ndihmën ekonomike që Kina i jep Shqipërisë dhe kredinë e re prej 25-30 milion rublash për objekte të pesëvjeçarit të tretë.

<sup>47</sup> *AMPJ*, V. 1964, D. 175 B/II-1, fl. 16-17. Shifrim tepër sekret i datës 26.8.1964 ndërmjet drejtorit të Bankës së Shqipërisë, Spiro Bakalli, dhe ambasadorit shqiptar në Pekin, Nesti Nase.

<sup>48</sup> *AQSH*, F. 14 / AP-MPKK, V. 1965, D. 4, fl. 2, 6, 9, 10, 11, 12. Procesverbal i bisedimeve mes Enver Hoxhës dhe Çu En Lait, më 27-29 mars 1965.

punimeve për ndërtimin e objekteve në Shqipëri deri në fund të vitit 1964 kapte shifrën e 2 miliard e gjysëm lekë.<sup>49</sup>

Shqipëria komuniste kishte gjetur më në fund një “sponsor” që po përmbushte dëshirat e saj. Sikur të mos mjaftonin të gjitha këto kredi dhe ndihma, komunistët shqiptarë shkuan edhe më tej kur në vitin 1964 me urdhër të Komitetit Qendror, Hysni Kapo udhëzonte ambasadorin shqiptar në Pekin, Nesti Nase, që Kina t’i dërgonte para Shqipërisë për të financuar luftën revolucionare në vendet e Amerikës latine dhe Afrikës.<sup>50</sup> Shifra që kërkonte Shqipëria nga Kina për të bërë të mundur “sponsorizimin” e lëvizjeve revolucionare në Amerikën Latine dhe Afrikë ishte 1 milion dollarë.<sup>51</sup> Kina kësaj kërkesë shumë të pavend nga ana e Shqipërisë nuk iu përgjigj.

### **Ndihmat dhe kreditë kineze, 1966-1970**

Pas vizitës së Çu En Lait, Shqipëria, me marrëveshjen e bërë, do të merrte një kredi të re nga Kina për pesëvjeçarën e katërt 1966-1970.<sup>52</sup> Për këtë pesëvjeçar, kërkesat e Shqipërisë do të kishin një rritje të ndjeshme. Me kredinë e re kineze, parashikohej që për planin e katërt pesëvjeçar me ndihmën e Republikës Popullore të Kinës, të ndërtoheshin 13 vepra të plota industriale, 12 reparte të ndryshme pranë uzinave dhe fabrikave ekzistuese dhe të kryheshin zgjerime në tre objekte ekzistuese.<sup>53</sup> Ndër veprat më të rëndësishme që do të ndërtoheshin ishin: hidrocentrali i Vaut të Dejës mbi lumin Drin, uzina metalurgjike për shkrirjen e mineralit të hekur nikelit dhe petëzimin e metalit, dhe uzina për prodhimin e ferro-kromit të rafinuar.<sup>54</sup> Kredia e re që kërkohet nga Republika Popullore e Shqipërisë duhej të ishte e përdorshme brenda viteve 1966-1970 dhe të shlyhej pas vitit 1990.<sup>55</sup> Nga përllogaritjet e shtojcave dhe lidhjeve që paraqiti Mehmet Shehu, Shqipëria kërkonte

<sup>49</sup> *Po aty*, fl. 115.

<sup>50</sup> *Po aty*, F.14 / AP-MPKK, V. 1964, D. 24, fl. 9. Letër e Hysni Kapos dërguar Nesti Nases.

<sup>51</sup> *Po aty*, fl. 10.

<sup>52</sup> *Po aty*, F. 14 / AP-MPKK, V. 1965, D. 25, fl. 28. Letër e Mehmet Shehut dërguar Çu En Lait lidhur me kërkesën e Shqipërisë për një kredi të re nga Kina për pesëvjeçarën e katërt 1966-1970, 22 janar 1965.

<sup>53</sup> *Po aty*, fl. 8.

<sup>54</sup> *Po aty*.

<sup>55</sup> *Po aty*, fl. 26.

33.3 milion rubla.<sup>56</sup> Pas vizitës së tretë të Çu En Lait në Shqipëri për të negociuar për kredinë e re shqiptare në qershor 1966, katër muaj më vonë, më 20 tetor 1966, qeveria kineze miratoi aprovimin e kredisë në fushën e industrisë dhe të naftës në shumën 14 milion e 300 mijë rubla<sup>57</sup> (39.039.000 yuan). Po për këtë vit, Kina i akordoi Shqipërisë një kredi në vlerën 32 milion e 596 mijë rubla (88.987.080 yuan) për ndërtimin e veprave të mëdha industriale.<sup>58</sup>

Ndërkaq, situata ndërkombëtare në vitin 1968 ishte acaruar jashtëzakonisht shumë për shkak të ndërhyrjes ushtarake të forcave të Traktatit të Varshavës të drejtuar nga Bashkimi Sovjetik në Çekosllovakia. Ndërhyrja sovjetike i dha shkak Shqipërisë që të dilte nga Traktati i Varshavës më 13 shtator 1968.<sup>59</sup> Duke qenë se kishte mbetur pa mbrojtje ushtarake dhe duke iu druajtur një pushtimi sovjetik, Enver Hoxha dërgoi në Kinë delegacione ekonomike dhe ushtarake të kryesuar nga Adil Çarçani, zëvendëskryeministër i parë i RPSH, dhe Beqir Balluku, ministër i Mbrojtjes Popullore. Të dy zyrtarët e lartë të qeverisë shqiptare nënshkruan marrëveshje të rëndësishme për mbrojtjen dhe ekonominë. Përsa i përket çështjeve ekonomike, Adil Çarçani më 20 nëntor 1968 nënshkroi dy marrëveshje me afat të gjatë pa interes në shumën 1.056.300.000 yuan dhe 86.100.000 yuan në valutë të lirë.<sup>60</sup> Më këtë kredi të madhe me ndihmën e Kinës do të ndërtoheshin plotësisht në Shqipëri 34 vepra.<sup>61</sup> Për mallrat dhe pajisjet që Shqipëria do të merrte nga Kina i duheshin edhe 146 milion e 300 mijë yuan kredi e cila do të fillonte të lëvrohej duke filluar nga viti 1970 e deri në vitin 1975.<sup>62</sup>

<sup>56</sup> *Po aty*, fl. 29-42.

<sup>57</sup> *AMPJ*, V. 1966, D. B.II-1, fl. 51. Çështje të ndryshme të bashkëpunimit ekonomik ndërmjet Kinës dhe Shqipërisë.

<sup>58</sup> *Po aty*, fl. 148.

<sup>59</sup> *Dokumente kryesore të Partisë së Punës të Shqipërisë*, vëll. V, Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste pranë KQ të PPSH, Tiranë: 1982, f. 412-413. Deklaratë e KQ të PPSH dhe e Këshillit të Ministrave të RPSH, 28 gusht 1968.

<sup>60</sup> *AQSH*, F. 14, AP/MPKK, V. 1968, D. 4, fl. 21, 24. Marrëveshje ndërmjet Republikës Popullore të Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Popullore të Kinës mbi dhënien e një kredie Shqipërisë nga ana e Kinës.

<sup>61</sup> *Po aty*, fl. 26.

<sup>62</sup> *AMPJ*, V. 1968, D. B/I-10, fl. 45.

Veprat më të rëndësishme ishin Kombinati Metalurgjik në Elbasan dhe Hidrocentrali i Fierzës.<sup>63</sup>

Kombinati Metalurgjik do të kishte një kapacitet për të shkrirë 800 mijë ton hekur-nikel të përpunuar duke përfshirë edhe uzinën e shkrirjes së hekur-nikelit me aftësi përpunimi 100 mijë ton në vit.<sup>64</sup> Kombinati Metalurgjik do të ndërtohej në dy faza: faza e parë parashikonte që të kishte një kapacitet shkrirjeje 300 mijë ton mineral në vit, ndërsa në fazën e dytë aftësia e shkrirjes rritej në 500 mijë ton mineral.<sup>65</sup>

Përsa i përket ndërtimit të Hidrocentralit të Fierzës, fuqia e tij fillestare parashikohej në 360-400 mijë kw.<sup>66</sup> Në tremujorin e parë të vitit 1969 do të vinte në Shqipëri grupi i parë i specialistëve kinezë për studimin dhe projektimin e hidrocentralit, ku do të përcaktohej përfundimisht edhe fuqia e vendosur për të. Sipas planit, projekti paraprak do të përfundonte në tremujorin e dytë të vitit 1971.<sup>67</sup> Pala kineze do të furnizonte pajisjet dhe materialet e nevojshme për studimet përkatëse.

Brenda kësaj kredie u përfshi edhe një sasi e jashtëzakonshme armatimi që kishte kërkuar në një takim sekret ministri i Mbrojtjes Popullore, Beqir Balluku me kryeministrin Çu En Lai më datë 6-7 tetor 1968.<sup>68</sup> Bisedimet për të bindur Çu En Lai-n që t'i akordohej Shqipërisë një sasi e jashtëzakonshme armatimi zgjatën nga ora 21:40 e datës 6 tetor deri në orën 02:00 të datës 7 tetor.<sup>69</sup> Pas daljes së Shqipërisë nga Traktati i Varshavës, ministri Beqir Balluku ia paraqiti situatën kryeministrit kinez sikur të nesërmen vendi do të sulmohej nga të gjitha drejtimet. Shqipëria kishte listuar 746 zëra në fushën e mbrojtjes të cilat kërkonin një armatim 50 mijë ton.<sup>70</sup> Përveç armatimit, Shqipëria kishte kërkuar edhe 6000 ton hekur beton për të filluar procesin e bunkerizimit të

<sup>63</sup> *AQSH*, F. 14, AP/MPKK, V. 1968, D. 4, fl. 30, 37. Lidhje e protokollit ndërmjet qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Popullore të Kinës mbi dhënien e ndihmës teknike dhe furnizimin e pajisjeve të plota Shqipërisë nga ana e Kinës.

<sup>64</sup> *Po aty*, fl. 30.

<sup>65</sup> *Po aty*.

<sup>66</sup> *Po aty*, fl. 37.

<sup>67</sup> *Po aty*.

<sup>68</sup> *Po aty*, F.14/AP-MPKK, V. 1968, D. 8, fl. 1. Mbi furnizimin me armë të RPSH dhe kërkesat e reja për forcimin e fuqisë mbrojtëse.

<sup>69</sup> *Po aty*.

<sup>70</sup> *Po aty*, fl. 3.

vendit.<sup>71</sup> Më kot përpiquej kryeministri kinez që të bindte interlokutorin e tij për pamundësinë e një lufte në shkallë të gjerë për t'u përballuar nga Shqipëria, por ishte e kotë. Më në fund, zyrtarët e lartë kinezë pranuan t'i dërgoheshin Shqipërisë 108 topa 37 mm dygrykësh, 600 tanke, 72 avionë, 30 helikopterë, 24 katera, 180 silurë, dy grupe raketash tokë –ajër “Rrufe 2” si dhe 200 milion predha.<sup>72</sup> Se sa do të kushtonte e gjithë kjo sasi municioni dokumentet nuk na e sqarojnë, por mendojmë se një pjesë shumë e madhe nga kredia e lartpërmendur do të shkonte për të paguar gjithë këtë armatim. Në kuadrin e një lufte frontale, siç e paraqiste Beqir Balluku, edhe duke patur tërë këtë armatim, Shqipëria nuk kishte asnjë shans të fitonte jo e jo, por as të ndalte një invazion të mundshëm nga ana e forcave të Traktatit të Varshavës apo NATO-s. Paranoja për të ruajtur me çdo kusht pushtetin e tij po kthehej në një armë vdekjeprurëse për popullin shqiptar, i cili duhej të mbante mbi kurriz jo vetëm diktaturën e egër të Hoxhës, por edhe kreditë e rënda. Është folur dhe propaganduar shumë mbi të ashtuquajturën pavarësi financiare të Shqipërisë në epokën e Luftës së Ftohtë. Dokumentet e paraqitura në këtë artikull mendojmë se provojnë tërësisht të kundërtën.

Pa kaluar dy vjet nga aprovimi i kredisë së 20 nëntorit 1968, në vitin 1970, kryeministri shqiptar Mehmet Shehu i drejtohet më 12 mars 1970<sup>73</sup> Çu En Lait me një kërkesë të re për akordimin e një kredie tjetër për pesëvjeçarin e pestë 1971-1975.<sup>74</sup> Shifra që kërkonin shqiptarët ishte 335 milion rubla (914 milion yuan).<sup>75</sup> Interesant është fakti se të gjitha kërkesat për kredi, Shqipëria përpiquej t'i justifikonte se "gjendej e rrethuar nga armiqtë". Vendimi për kredinë e re i mori Kinës tetë muaj dhe u

<sup>71</sup> *Po aty*. Nga fjala e Çu En Lait: “Veç kësaj ju keni kërkuar edhe 6000 ton hekur betoni. Këtë kërkesë do t’jua plotësojmë”.

<sup>72</sup> *Po aty*, fl. 15, 16.

<sup>73</sup> *Po aty*, F. 14/AP-MPKK, V. 1970, D. 6, fl. 14. Letër e Mehmet Shehut drejtuar Çu En Lait, 12 mars 1970.

<sup>74</sup> *Po aty*, fl. 1. Letër e Mehmet Shehu drejtuar Enver Hoxhës dhe kopja e letrës së Këshillit të Ministrave të RP të Shqipërisë drejtuar Këshillit të Shtetit të RP të Kinës, si dhe listat përkatëse mbi kërkimin e një kredie të re për pesëvjeçarin e pestë 1971-1975 të RPSH dhe dërgimin në RP të Kinës të delegacionit ekonomik qeveritar të kryesuar nga Abdyl Këllezi për të trajtuar kërkesat e Shqipërisë dhe përfunduar marrëveshjet përkatëse.

<sup>75</sup> *Po aty*, fl. 2.

akordua si dhuratë për ditëlindjen e Enver Hoxhës, më 16 tetor 1970.<sup>76</sup> Kredia e 16 tetorit 1970, ishte edhe më e madhja e akorduar nga Kina për Shqipërinë. Shifra e saj ishte 1.880.000.000 yuan.<sup>77</sup> Me një kredi të tillë, pushteti i Enver Hoxhës dhe i gjithë klikës së tij do të kishte një konsolidim të mëtejshëm dhe vendi do të kishte një rritje të vogël ekonomike që do të vërehej në të gjitha fushat e jetës në fillim të viteve '70. Gjithashtu, në këtë kredi përfshihej edhe dhënia e valutës së lirë në shifrën e 14 milion dollarëve amerikanë.<sup>78</sup> Shlyerja e kredisë do të kryhej gjatë 15 viteve duke filluar nga 1 janari 1986 deri më 31 dhjetor 2000, çdo vit me 1/5 e shumës së kredisë.<sup>79</sup>

Kredia e 16 tetorit 1970, e ngarkonte Shqipërinë që të eksportonte në Kinë naftë bruto, bitum naftë, mineral kromi, mineral hekur-nikeli, bakër blister, tela bakri të zhveshur, kompensatë, dok, konfesionë doku, pambuk, cigare, duhan etj., gjithsej në masën 1780 ton.<sup>80</sup> Gjithashtu, Shqipëria do të eksportonte në Kinë mijëra ton ushqime dhe pëlhura<sup>81</sup> të cilat mund të përdorehin për të përmirësuar nivelin ekonomik të shqiptarëve. Nga të gjitha këto eksporte, shqiptarët do të detyroheshin të jepnin edhe rrobat e trupit, edhe bukën e përditshme për të përmbushur dëshirat ekstravagante të Enver Hoxhës. Shqiptarët do të visheshin të gjithë njëjloj, do të kishin të njëjtën xhakëtë, këmishë e pallto si dhe shtëpitë do të ishin të sistemuara, thuajse të gjitha njëjloj. Kush mund të kishte një gjë paksa ndryshe rrezikohej të quhej armik i klasës punëtore.

### **Ndihmat dhe kreditë kineze, 1971-1975**

Pas pranimit në tetor 1971 të Republikës Popullore të Kinës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, marrëdhëniet e Shqipërisë me

<sup>76</sup> *AQSH*, F. 14/AP-MPKK, V. 1970, D. 8, fl. 2. Kopje të marrëveshjeve dhe protokolleve të nënshkruara në Pekin, më 16 tetor 1970, midis qeverisë së RP të Shqipërisë dhe qeverisë së RP të Kinës mbi dhënien e një kredie me afat të gjatë e pa interes Shqipërisë nga ana e Kinës për vitet 1971-1975, mbi furnizimin e veprave të plota, mbi dhënien e materialeve të përgjithshme, mbi shkëmbimin e mallrave dhe pagesat për vitin 1971 si dhe mbi përdorimin në vitin 1971 kredisë së dhënë nga Kina, të cilat i kanë ardhur KQ të PPSH nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe qeveria.

<sup>77</sup> *Po aty*, fl. 4.

<sup>78</sup> *Po aty*, fl. 5.

<sup>79</sup> *Po aty*.

<sup>80</sup> *Po aty*, fl. 32. Lista e mallrave që Republika Popullore e Shqipërisë do të eksportoje në Republikën Popullore të Kinës në vitin 1971.

<sup>81</sup> *Po aty*, fl. 33.

vendin e fuqishëm aziatik filluan rënien e lirë. Më 29 shtator 1972, Enver Hoxha priti ambasadorin e Republikës Popullore të Kinës në Shqipëri, Liu Xhen Hua.<sup>82</sup> Në këtë takim, Enver Hoxha i foli ambasadorit Hua lidhur me disa probleme që kishin dalë gjatë ndërtimit të Kombinatit Metalurgjik në Elbasan.<sup>83</sup> Ambasadori Liu Xhen Hua premtoi se Kombinati Metalurgjik do të ngrihej patjetër dhe se për këtë çështje ishin preokupuar shumë kryetari Mao ashtu edhe kryeministri Çu En Lai.<sup>84</sup>

Edhe pse kishte marrë shumë ndihma dhe kredi nga Kina, Shqipëria kishte përsëri vështirësi të theksuara ekonomike. Për të matur pulsën nëse mund të merrnin përsëri kredi nga Kina, Enver Hoxha dërgoi më 7 nëntor 1972, ministrin e Tregtisë Kiço Ngjela dhe ministrin e Mbrotjes Popullore, Beqir Balluku në Pekin.<sup>85</sup> Ministrat shqiptarë u pritën në takim nga kryeministri Çu En Lai, të cilët i falënderoi për ndihmën e jashtëzakonshme që kishte dhënë Shqipëria për pranimin e Kinës në OKB.<sup>86</sup> Madje, kryeministri kinez u tregua edhe pak sarkastik duke u thënë ministrave shqiptarë se "*ju patët hall sa të na futnit në OKB dhe tashti nuk pyesni më për ne*".<sup>87</sup> Ishte një shaka e hollë diplomatike dhe një mesazh i drejtpërdrejtë për të gjithë ata që dinë të lexojnë ndër rreshta, kur një shtet ka filluar të ta mbyllë derën. Megjithë parashtrimet e kërkesave sidomos për mbrojtjen nga ana e ministrit Balluku, të dy ministrat shqiptarë këtë herë u kthyen duarbosh nga Pekini. Megjithatë, delegacionet e nivelit të lartë nga Kina nuk u ndalën së ardhuri në Shqipëri.

Një delegacion i lartë i bankës së Kinës i kryesuar nga zëvendës drejtori i Përgjithshëm Çao Pei Si mbërriti në Shqipëri për një vizitë zyrtare nga data 9 deri më 19 tetor 1972.<sup>88</sup> Qëllimi i vizitës së delegacionit të bankës së Kinës ishte të maste pulsën e aftësisë së ekonomisë shqiptare mbi disa aspekte të planifikimit dhe zbatimit të kreditit për ndërmarrjet industriale, tregtare dhe bujqësore, mbi disa

<sup>82</sup> *Po aty*, F. 14/AP-MPKK, V. 1972, D. 5, fl. 1. Biseda e Enver Hoxhës me ambasadorin kinez Liu Xhen Hua, gjatë darkës së shtruar me rastin e 23 vjetorit të shpalljes së RPK, datë 29 shtator 1972.

<sup>83</sup> *Po aty*, fl. 18.

<sup>84</sup> *Po aty*.

<sup>85</sup> *Po aty*, F. 14/AP-MPKK, V. 1972, D. 10, fl. 1.

<sup>86</sup> *Po aty*, fl. 10.

<sup>87</sup> *Po aty*.

<sup>88</sup> *AMPJ*, V. 1972, D. 136, fl.15. Mbi vizitën e delegacionit të bankës kineze në Shqipëri.

çështje të planifikimit dhe zbatimit të planit të arkës dhe qarkullimit monetar, mbi kreditimin e kooperativave bujqësore, objektet e kredive me afat të shkurtër dhe të gjatë si dhe mbi organizimin, funksionet dhe detyrat kryesore të Bankës Bujqësore në drejtim të fshatit dhe vizita në ndërmarrje e institucione të ndryshme.<sup>89</sup> Edhe këtë herë, delegacioni i lartë bankar kinez nuk bëri asnjë premtim për ndihmë apo kredi të re.

Në vitin 1974, ministri i Tregtisë, Kiço Ngjela, i raportonte Enver Hoxhës mbi disa të dhëna të përgjithshme të dala gjatë bisedave me delegacionin tregtar kinez në Tiranë që kryesohej nga ministri i Tregtisë Li Cian.<sup>90</sup> Informacioni që Kiço Ngjela i dërgoi më 17 janar 1974, e vuri seriozisht në mendime Enver Hoxhën. Sipas bisedës që kishte kryer ministri shqiptar i Tregtisë, kinezët kërkonin që diferenca e çmimeve të mbulohej vetëm me rritjen e çmimit të naftës bruto që Shqipëria shiste në vendet kapitaliste dhe se ky veprim duhej të bëhej vetëm për vitin 1974, ndërsa për vitet e tjera nuk pranonin.<sup>91</sup> Sipas Ngjelës, dilte se nga rritja e çmimit të naftës duke marrë çmimin mesatar të shitjes në vendet kapitaliste, Shqipëria do të kishte një përfitim në masën rreth 7 milion rubla, kurse me çmimin maksimal 8 milion rubla, pra diferenca e çmimeve të rieksporit do të ishte rreth 2,3. ose 3,4 milion rubla.<sup>92</sup> Ministri rekomandonte që të pranohej propozimi i palës kineze, mbasi nuk shikonte rrugëzgjdhje tjetër.

Por, Enver Hoxha nuk kishte nevojë për rekomandime. Atij i duhej që Kina të vijonte të dërgonte ndihma dhe kredi siç kishte vepruar në mënyrë të pakursyer në vitet '60. Goditjet që dha në kulturë, ekonomi dhe ushtri për të justifikuar dështimet e radhës dhe për t'i paraqitur si justifikime pranë kinezëve nuk po jepnin më rezultate. Megjithatë, një vit më vonë, në qershor 1975, në Kinë për të kërkuar një kredi të re për pesëvjeçarën e gjashtë 1976-1980 do të shkojë i udhëzuar drejtpërdrejtë

---

<sup>89</sup> *Po aty*, fl. 16.

<sup>90</sup> *AQSH*, F. 14/AP-MPKK, V. 1974, D. 2, fl. 5. Informacion i kryetarit të Këshillit të Ministrave të RPSH, Mehmet Shehu dhe letër e ministrit të Tregtisë Kiço Ngjela drejtuar Enver Hoxhës lidhur me bisedën e zhvilluar me delegacionin tregtar të RP të Kinës të kryesuar nga ministri i Tregtisë Li Cian. - Mbi kompensimin e vleftës së rieksporit të mallrave që Kina blen nga vendet e tjera për Shqipërinë me çmime më të larta.

<sup>91</sup> *Po aty*.

<sup>92</sup> *Po aty*.

nga Enver Hoxha, zëvendëskryeministri i parë i RPSH-së Adil Çarçani.<sup>93</sup> Në një takim tepër sekret, Enver Hoxha udhëzon Adil Çarçanin që të bëjë çmos të arrijë të marrë një kredi të re për ekonominë shqiptare, madje të pranonte menjëherë aq sa do t'i akordonin kinezët.<sup>94</sup> Megjithatë, si për t'i bërë një farë presioni kinezëve, nëse kredia që do të akordohej nuk do të ishte e kënaqshme, Enver Hoxha udhëzoi Adil Çarçanin që duhej të thoshte se "do t'ju drejtohem prapë për kredi të re".<sup>95</sup>

Delegacioni ekonomik shqiptar mbërriti në Kinë më 14 qershor 1975 dhe do të qëndronte atje deri në fillim të korrikut 1975.<sup>96</sup> Raporti që i paraqiti Adil Çarçani, Enver Hoxhës, më 12 korrik 1975 ishte tejet i zymtë.<sup>97</sup> Edhe pasi ishte përpjekur për ta kthyer nga të gjitha anët rëndësinë që do të kishte marrja e një kredie të madhe për Shqipërinë nga ana e Kinës, kinezët nuk kishin qenë dakord. Në marrëveshjen e nënshkruar në Pekin, më 3 korrik 1975 ndërmjet Adil Çarçanit dhe Li Hsien Nienit, pala kineze kishte rënë dakord që Shqipërisë t'i akordohej një kredi prej 500 milion rublash (1.365.000.000 yuan) nga 1 miliard e 200 milionë rubla (3.276.000.000 yuan) që kishte kërkuar pala shqiptare.<sup>98</sup> Kredia e 3 korrikut 1975 ishte edhe e fundit përse i përket ndihmave dhe kredive që Shqipëria kishte marrë nga Kina. Nga kjo kredi, vepra më e rëndësishme që do të ndërtohej ishte hidrocentrali i Komanit me fuqi 600 mjë kw/h si dhe nënstacionet përkatëse.<sup>99</sup> Megjithatë, Enver Hoxha nuk u dorëzua, pasi nëse do të prishej edhe me Kinën, vendi do të izolohej tërësisht dhe mbështetje tjetër nuk do të kishte. Në nëntor 1975, ai dhe Mehmet Shehu bënë përpjekjen e fundit për të marrë ndihma të

<sup>93</sup> *Po aty*, F. 14/AP-MPKK, V. 1975, D. 2, fl. 1. Shënime nga takimi i Sekretarit të Parë të KQ të PPSH, Enver Hoxha, me anëtarë kryesorë të delegacionit ekonomik shqiptar që do të shkojë në RP të Kinës, të kryesuar nga anëtari i Byrosë Politike dhe zëvendëskryetar i parë i Këshillit të Ministrave, Adil Çarçani, datë 14 qershor 1975, ku jepen udhëzime mbi kredinë e re që do t'i kërkohet Republikës Popullore të Kinës për pesëvjeçarin e gjashtë 1976-1980.

<sup>94</sup> *Po aty*, fl. 2.

<sup>95</sup> *Po aty*, fl. 3.

<sup>96</sup> *Po aty*, fl. 4.

<sup>97</sup> *Po aty*.

<sup>98</sup> *Po aty*, fl. 75. Marrëveshje ndërmjet qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Popullore të Kinës mbi dhënien e një kredie me afat të gjatë pa interes Shqipërisë nga ana e Kinës.

<sup>99</sup> *Po aty*, fl. 87.

konsiderueshme ushtarake nga Kina, por as nga Mao Ce Duni dhe as nga Çu En Lai nuk pati ndonjë përgjigje.<sup>100</sup>

### Përfundime

Në mbyllje të këtij artikulli besoj se është e dukshme se të dyja palët janë larg shifrave reale të pasqyruara. Pala kineze është përpjekur ta rrisë shumën (10 miliard yuan e barabartë me 6.250.000.000 US\$), ndërsa pala shqiptare ta minimizojë në maksimum (3 miliard yuan e barabartë me 1.875.000.000 US\$). Jam përpjekur që të paraqes sa më objektivisht bazuar në dokumentet autentike të shfrytëzuara në arkivat shqiptare shifrat e kredive nga Republika Popullore e Kinës akorduar Shqipërisë nga gjysma e dytë e viteve '50 deri në vitin 1975. Në notën e 7 korrikut 1978 pala kineze vinte në dukje ndihmat dhe kreditë për Shqipërinë nga viti 1954. Nga hulumtimi disaveçar i kryer në Arkivin Qendror të Shtetit dhe në Arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme në Tiranë, rezultati përfundimtar sipas dokumenteve që kemi hulumtuar dhe që i paraqitëm në këtë artikull është si më poshtë:

- Kredia e parë e marrë nga Republika Popullore e Kinës është në vitin 1958 me 150 milion yuan;
- Në vitet 1960-1961 janë akorduar dy kredi në shumat 57 milion yuan dhe 1.365.000.000 yuan.
- Po në vitin 1961 janë akorduar 81.900.000 yuan.
- Në vitin 1966 janë akorduar dy kredi prej 38.039.000 yuan dhe 88.987.080 yuan.
- Në vitin 1968 janë akorduar tre kredi përkatësisht në shumën 86.100.000 yuan, 1.056.300.000 yuan dhe 146.300.000 yuan.
- Në vitin 1970, Shqipërisë iu akordua kredia më e madhe, e cila kapte shifrën e 1.880.000.000 yuan.
- Në vitin 1975 kemi kredinë e fundit të akorduar nga Republika Popullore e Kinës Shqipërisë në shumën 1.365.000.000 yuan.

Gjithsej nga Republika Popullore e Kinës janë akorduar 6.315.626.080 yuan e barabartë me 3.947.266.300\* dollarë amerikanë.

<sup>100</sup> *Po aty*, F. 14/AP-MPKK, V. 1975, D. 10, fl. 1. Letër e firmosur nga Enver Hoxha dhe Mehmet Shehu drejtuar kryetarit Mao Ce Dun dhe kryeministrit Çu En Lai, mbi nevojën e Shqipërisë për t'u pajisur me armë, 12 nëntor 1975.

\* Kursi i këmbimit dollar/yuan në vitin 1978 sipas burimit të Bankës Botërore ishte 1 USD = 1.6 yuan. [www.worldbank.org/usdollarcnychina](http://www.worldbank.org/usdollarcnychina)

Për kursin e këmbimit në vitet '60 dhe '70 rubël/yuan dhe dollar/yuan falënderoj profesorin e Fakultetit Ekonomik në Universitetin e Tiranës, dr. Petrit Dollani për ndihmën dhe informacionin tepër të çmuar. Shifrat që kemi nxjerrë janë marrë nga arkivat shqiptare. Gjatë qëndrimit tim në Kinë në programin studimor ndërkombëtar "China Studies" nga data 10-30 shtator të vitit 2017 nuk kam mundur të hulumtoj arkivat kineze pasi ishin të mbyllura.

### *S u m m a r y*

#### THE CHINESE LOANS AND ASSISTANCE TO ALBANIA (1956-1975)

The relations between the People's (Socialist) Republic of Albania and the People's Republic of China were very special between the '60-ies and '70-ies of the XX century. After the break with the Soviet Union, China helped Albania in every possible way. During the search in the Albanian Archives. I found that between the 1958 and 1975, China has delivered to Albania 6.169.326.080 yuan equivalent of 3.855.828.800 US\$. This huge amount made possible the economic survival of Albania after the break off relations with the Soviet Union and with any other potential partner in the world. This amount helped the communist regime of Enver Hoxha to survive for another thirty years after the partial and total isolation from the rest of the world from 1961 to 1991.